

EVALDA PACI

PIKËPAMJE MBI METODOLOGJINË E STUDIMIT TË TEKSTIT NË VEPRAT E LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE

Studimi i tekstit në veprat e letërsisë së vjetër shqipe përbën një premisë që karakterizon edhe sprovat e para që synuan të veçonin elemente tekstore sa më domethënëse në përmbajtjen e tyre. Të tilla sprova kontribuojnë pa dyshim si në ngulitjen e konceptit mbi modele të veçanta tekstore, ashtu dhe mbi metodën e hulumtimit të pjesëve të caktuara nga këto vepra. Nisur dhe nga destinacioni i botimeve që ndër të tjera kanë objekt të vetin dhe këto vepra të rëndësishme për historinë e letërsisë së shkruar shqipe, përmasat e teksteve të përzgjedhura, gjithashtu edhe tematika e përmbajtja e tyre paraqiten të kushtëzuara nga këta parametra¹. Dhe brenda vetë botimeve që kanë objekt trajtimi tekste të shkëputura nga veprat e kësaj letërsie, mund të dallojmë diferencime në drejtim të metodës së punës apo dhe këndvështrimeve të ndryshme sa u takon qëmtimeve të tekstit. Nëse ilustrim pikërisht me njërin vëllim të botimit me titull *Shkrimtarët shqiptarë, I* të vitit 1941, përgatitur nga Namik Ressler e kujdesuar nga Ernest Koliqi, vetë paragrafet kushtuar autorëve kryesorë të kësaj periudhe diferencohen në pikëpamje të vëllimit, mënyrës së trajtimit të anës përmbajtësore, vëllimit konkret që diktohet nga natyra e vetë veprës apo pjesëve që i karakterizojnë më mirë ato, por dhe metodologjisë së shqyrtimit nëse kemi parasysh faktin që jo të gjithë autorët u kujdesuan nga i njëjti studiu. Autorët e kësaj letërsie në vëllimin me titull

¹ E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe (me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme)*, Shtypshkroja e Ministrisë s'Arsimit, Tiranë, 1936. Paraqitja e autorëve kryesorë të letërsisë së vjetër shqipe, e autorëve arbëreshë dhe e teksteve përfaqësuese të shkrimtarisë së tyre përbëjnë një model të arrirë në pikëpamje të një trajtimi sa të përshtatshëm për shkollat shqiptare, aq dhe prijës për realizime të mëtejme në përmasa më të zgjeruara.

Shkrimtarët shqiptarë I trajtohen përkatësisht nga Justin Rrota dhe Filip Fishta. Justin Rrota ndër të tjera njihet dhe si gatitës tekstesh të ngjashme me destinacion pikërisht historinë e letërsisë së shkruar shqipe përshtatur dhe për nivele shkollore parauniversitare. Janë të njohura shënimet me të cilat ai pajis kolofonin e librit të Buzukut, pjesët e përzgjedhura nga Pjetër Budi e më tej nga Frang Bardhi, Pjetër Bogdani e Kuvendi i Arbënit (1706), titujt me të cilat introdukton të tilla pjesë, pikëpamjet që shpreh në lidhje me këta autorë dhe vendin e tyre në historinë e letërsisë së shkruar shqipe².

Veçanërisht në paragrafet e vëllimit të sipërcituar shquhet qartë vëmendja e J. Rrotës ndaj trajtave me origjinë latine, emërtesave që i përkasin regjistrit të liturgjisë, elementeve tekstore që i përkasin leksikut dituror në fushë të bibliofilisë, fjalësh të ngjashme nga kuptimi e që përdoren në një kontekst të afërt³, por dhe trajtave gjuhësore që tërheqin vëmendjen e dialektologut apo filologut.

Me mjaft interes paraqitet kontributi për Gjon Nikollë Kazazin, integruar në të njëjtën pjesë të këtij vëllimi e që përmban shënime veçuese mbi grafinë e shenjat përkatëse të përdorura prej tij, vendin që i takon në historinë e shkrimit të shqipes dhe shënimet me të cilat

² Secila nga trajtesat introductive mbi këto vepra përbën një kontribut me vlerë dhe me të dhëna të vyera në disa pikëpamje. Vëmendja e Justin Rrotës drejtohet në vijimësi ndaj aspektesh të ngjashme në shkrimtarinë apo tipare të grafematikës së këtyre veprave. Elemente biografike mbi këta autorë, por dhe vërejtje mbi përmbajtjen e veprave përkatëse introdukojnë sythet me shënime tekstologjike që përmbahen në këtë vëllim. Justin Rrota rishfaqet si njohës i mirë i këtyre veprave, fakt ky që lexohet qartë në këto shënime, në të cilat në mënyrë të shumanshme spikat një përgatitje e një dije e jo e zakonit në drejtim të gjurmimit të këtyre teksteve. Këtij kontributi i prijnë në kohë botime që mbajnë autorësinë e tij e nga të cilat veçojmë përkatësisht: *Letratyra shqype* (Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1925); *Monumenti më i vjetri i gjûhës shqype D.Gjon Buzuku (1555) / Copa të zgjedhuna e të komentueme për shkolla të mjesme* (Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1930; ribotim në vitin 1938); *Per historín e alfabetit shqyp*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1936.

³ Shih pikërisht shpjegimet përkatëse të Justin Rrotës O.F.M. në lidhje me fjalët zgedhësi e letërarë në *Shkrimtarët shqiptarë I* (nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë), botim i cituar, f. 56.

shoqërohen dy fragmente nga Compendiumi i tij doktrinar⁴. Dhe pse u referohen dy pjesëve të shkurtra nga kjo vepër, këto shënime dëshmojnë vëmendjen e gatitësit të tyre kryesisht ndaj trajtash të caktuara foljore dhe vetë njohjen e thelluar nga ana e tij e kësaj vepre.

Vështrimi tekstologjik ndaj këtyre veprave dhe pse gjithnjë në botime me destinacion shkollor vërehet dhe në më vonë, sikundër dhe në atë me titull *Letërsia e vjetër dhe arbëreshe (tekst për kl. e III-të të shkollave të mesme)*, Tiranë, 1952. Botimi paraqitet serioz në disa pikëpamje, jo vetëm për trajtesat që synojnë në këndvështrime të kontekstit historik, por dhe për shpjegime të mjaftueshme ndaj përmbajtjes së teksteve përkatëse të autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Për t'u vënë në dukje vërejtje mbi alfabetin dhe shenja të veçanta grafike nga të tilla vepra, si dhe përzgjedhja tekstore që në ndonjë rasë përkon me atë të sipërcituar nga Justin Rrota në vëllimin *Shkrimtarët shqiptarë I*, ndërsa shënimet dhe pse të mjaftueshme për një libër të tillë, priren ndaj shpjegimesh konkrete e të një natyre tjetër. Dhe pse i ndan një hapësirë e vogël kohore, pikëpamjet e interpretimit përmbajtësor në disa raste i diferencojnë këto botime⁵.

Të tilla botime meritojnë vëmendje e vlerësim sepse përbëjnë hapa propedeutikë e përafrues me letërsinë e vjetër shqipe, hapa këta që përforcohen me konsultimin e mëtejshëm të vetë veprave në variant më të plotë, sidomos në dimensione botimesh të mirëfillta kritike, tekstologjike e filologjike. Botimi i pjesshëm i disa copave nga këto vepra e që nuk u zgjodhën në mënyrë të rastësishme nga përpiluesit

⁴ Shih në veçanti paragrafin e përgatitur nga Filip Fishta në *Shkrimtarët shqiptarë I (nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë)*, Botim I, 1941, f. 65-68.

⁵ Shih ndër të tjera dhe shprehjen e ndonjë pikëpamjeje mbi qëndrimin e autorit (P. Bogdanit) në lidhje me trajtesa të tij mbi astrologjinë dhe ndikimin e planetëve në jetën e njeriut në *Letërsia e vjetër dhe arbëreshe, vëllim i cituar*, Tiranë, 1952, f. 52. Shihet qartë një prirje për të nënvizuar vlerën "patriotike" të veprës së Bogdanit, shprehur në disa raste, qoftë dhe në shpjegime fjalësh apo sintagmash, në veçanti dhe në shënimet që shoqërojnë tekstin *Virtyti dhe burrnia e malësorit, po aty*, f. 52-53.

e botimeve të sipërcituara, përbën një pikënisje domethënëse në drejtim të thellimit të mëtejshëm të studimit të përmbajtjes së tyre.⁶

Në këtë trajtesë tonën ritheksojmë pikëpamjen që çështja e studimit të tekstit në veprat e letërsisë së vjetër shqipe do parë si një problem që kërkon konsiderimin e natyrës tekstologjike të secilës prej këtyre veprave. Kësisoj vlerësohet më objektivisht dhe kontributi i secilit autor që në përballjen konkrete me shqipërimin apo përshtatjen e modeleve të ofruara nga koha në të cilën jetuan realizuan përpilime që dhe sot e kësaj dite me të drejtë konsiderohen të papërsëritshme për shumë arsye. Që pa dyshim një kontekst konkret që bëri të mundur që me gjithë vështirësitë që përmenden prej vetë autorëve të shohin dritën e botimit variante të Doktrinës së Kërshtenë, Pasëqyra e të Rrëfyemit që plotëson natyrshëm tematikën e Doktrinës, edhe pjesë nga Rituali Romak, fakte këto që krejt qartë ripohojnë sa e rëndësishme ishte të zotëroheshin doracakë të tillë në atë kohë dhe në viset tona.

Ndërtimi i gjithsecilës ofron mundësi konkrete si për vëzhgimin tërësor të përmbajtjes tekstore, ashtu dhe për veçimin e disa modeleve apo nënndarjeve që i bëjnë këto vepra dhe të veçanta e të dallueshme prej të tjerave.

Fakti që ndeshim natyra të ngjashme tekstesh në më tepër se një vepër, bën të mundur dhe qasjen mes variantesh që në radhë të parë përfaqësojnë shqipërime tekstesh biblike. Një hapësirë kohore prej më se një shekulli ndan librin e Gjon Buzukut me *Cuneus prophetarum* të Pjetër Bogdanit (1685), por një fakt i tillë e bën dhe më me interes krahasimin mes tekstesh të njëjta (i referohemi ndonjë vargu nga psalteri apo ndonjë citimi tjetër të ngjashëm) apo vënien në dukje të rimarrjeve të motiveve të ngjashme përmbajtësore.

Pa dyshim që studimi tekstologjik i shërben ndjekjes së vijimësisë së përdorimeve të caktuara, në veçanti atyre përdorimeve të cilat janë thellësisht të rrënjësura në formimin e autorëve të

⁶ U referohemi në veçanti kontributeve të E. Çabejt, P. Skiroit e G. Petrottës, J. Rrotës O.F.M., F. Fishtës, kontribute që jo vetëm pasojnë njëri-tjetrit dhe i shërbejnë përrurimit të pasurisë së vyer gjuhësore e letrare të shqipes së vjetër, por natyrshëm janë pjesë e historisë së studimeve mbi librin e parë në gjuhën shqipe që njihet deri më sot dhe më gjerë mbi tekstet e vjetra shqipe.

letërsisë së vjetër shqipe. Në mbështetje të kësaj pikëpamjeje do të veçonim ndër të tjera rastin e foljes *fëjej*, në pamje të parë të lidhur ngushtë me konceptin e mëkatit (Buzuku, Bogdani), por në autorë të tjerë dhe me zgjerim kuptimor që nuk duket se i largohet këtij kuptimi të sipërpërmendur.

Autorët më të parë të kësaj tradite shkrimore kanë pasur rast ta përdorin këtë fjalë në pjesë të ndryshme të veprave përkatëse. Denduria e përdorimit të Gjon Buzuku bie në sy në pjesë më të veçanta që për vetë natyrën konkrete dhe shumë të specifikuar na mundësojnë dhe konsultime me variante gjegjëse referenciale. Ndër të tjera, dhe përdorimi i shpeshtë me një kuptim mirëfilli të përcaktuar në pjesën e katekezës dhe dekalogut, ashtu dhe përdorime të përafërta në pasthënien e veprës, gjithashtu dhe përdorimi krejt i veçantë në ndonjë pjesë biblike na përforcon mendimin se një fjalë e tillë ishte e rrënjësuar në regjistrin specialistik të këtyre përdorimeve para kohës së përgatitjes së saj⁷.

Për këdo që ndërmerr një vështrim të natyrës analitike mbi të tilla përdorime, bëhet e qartë që veçanërisht nëse bëhet fjalë për raste specifike, natyrshëm gjurmohet dhe një fushë semantike korrelative. Mjafton t'u referohemi psalmeve të pendesës në *Mesharin* e Gjon Buzukut, po ashtu dhe lutjeve themelore të liturgjisë së orëve; ligjëratave përkatëse në veprën e Pjetër Bogdanit, në paragrafe të së cilës argumentohen konceptime të tëra bashkë me veshjen emërtuese përkatëse.

Gjurmimi tekstologjik bën të mundur ndër të tjera zbulimin e një lidhjeje tematike mes pjesëve të caktuara në brendinë e vetë veprave të letërsisë së vjetër shqipe. Gjurmimi i paragrafeve që zakonisht

⁷ Autori përdor foljen e sipërcituar në pjesët e sipërpërmendura në vepër, ndërkohë që po aq shesh bie në sy dhe përdorimi i emrit *kat* dhe i një sërë elementesh që ruajën qartë lidhje semantike me të dyja këto fjalë. Shih në veçanti De septem operibus misericordie (*Meshari, botim kritik i cituar, Pjesa e dytë*, f. 65-67/a); Cathecuminum exorcismorum (*Meshari, botim kritik i cituar, Pjesa e dytë*, f. 67-69/a) etj. Shih gjithashtu Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Shkodër, 1996, f. 308; përkatësisht f. 350. Sa i takon citimit nga Ashta të emrit *kolpë* shih sërish në këtë vëllim të cituar, f. 344, ndërsa në lidhje me participin *enkuipuum* (*cit.*) shih *po aty, vëllim i cituar*, f. 298.

pasojnë njëri-tjetrit bën të mundur dhe konstatimin e pranisë së përdorimeve që sa janë pjesë e tekstit, aq dhe pasqyrojnë linjën e mendimit të vetë autorit të veprës.

Një linjë e tillë natyrshëm argumentohet në lidhjen dhe integrimin e pjesëve të Ungjillit që sillen në përbërje të Offices; gjithashtu ndiqet ndërsa studiohen paragrafe që lidhen me Gjenezën dhe konceptimin tërësor e organik të saj në pikëpamjen e Pjetër Bogdanit; ndiqet gjithashtu në pjesë të tjera të veprës së këtij autori, ndërsa receptohet qartë që një korpus i tërë citimesh dhe autorësh nga fusha e patrologjisë, Ungjijtë dhe agjiografia vetë janë bërë pjesë e projektit të këtij autori në proces të realizimit të veprës.

Çka vlen të bëhet objekt shqyrtimi të vetë Pjetër Bogdani është pikërisht referimi i shpeshtë që ai i bën Biblës në kuptimin e sjelljes prej saj të pjesëve sa koncize aq dhe logjikisht të lidhura me trajtesat e tij të shprehura në përmasa ligjëratash apo sermonesh.

Në këtë vepër gjurmojmë jo vetëm gjetje që qëndrojnë më së miri në objektin e saj kryesisht ezegjetik e filozofik, por dhe lidhje mes përdorimesh që iniciohen në autorët paraardhës që kishin ndërmarrë sprovë të një natyre tjetër tekstologjike, por aspak të largëta me vetë veprën e Bogdanit.

Nënndarjet në të cilat Bogdani ka shprehur konceptimin e veprës së vet i kanë mundur, por njëkohësisht dhe kushtëzuar një sërë gjetjesh që nuk mund të konsiderohen vetëm gjuhësore. Ato i shërbejnë një qëllimi më suprem e më saktë objektivit kompleks të ndërmarrë prej autorit të veprës, i vënë përballë një realizimi që nuk kërkonte tashmë vetëm trajtesa në gjuhën mëmë të tij, por dhe përballjen e kësaj të fundit me një gjuhë tjetër e më tej dhe qasjen me burime të shkruara në gjuhën latine, të sjella në variante që meritojnë vëmendjen e çdo studiuesi që ndërmerr hulumtime tekstore ndaj veprës së Bogdanit.

Në këtë pikëpamje arrijmë jo vetëm të rikonfirmojmë konotacionin që marrin fjalë e toje të caktuara në autorët paraardhës të Bogdanit, por dhe të vërejmë se ky autor arrin të bëjë po aq eficiente fjalë të së njëjtës familje apo fushë semantike, duke përforcuar shkallën e përdorimit në një regjistër specifik si ai i fushës së teologjisë.

Nga ana tjetër, është krejt e qartë që me gjithë vështirësitë që sjell ndërmarrja e një vepre si *Cuneus prophetarum*, autori ka arritur të pranëvërë e të tërheqë vëmendjen mbi vlerën konotative që në të tilla kontekste marrin përdorime a fjalë të caktuara. Pjetër Bogdani ka pranëvënë ndër të tjera emrat *shembëlltyrë* e *gasë*, pranëvënie kjo që paraqet veçanti në pikëpamje të nëntekstit që përcjell, ndërkohë që autori u referohet burimeve teologjike:

SS Dotorë të Kishësë duenë me thanë se tjetër është *shembëlltyra*, tjetër është *gasa*. Përse thonë se nierë është *mbë shembëlltyrë* të Tinëzot ndëpër të mira të natyrësë qi pat prej Tinëzot për të gjëllitunë këtë jetë. *Mbë gasë* të Tinëzot i thonë ndëpër hirt e të dashunit e ndëpër vërtytë të hyjënueshime. Prashtu *shembëlltyra* qi ecën për natyrë kurraj nukë dvaretë, ndonë shpirti t'ish ndë Ferrë. Ma *gasa* dvaretë për një si të dvaretë hiri e të dashunitë, të sijatë dvarenë për qishdo mpkat murtar.

Li Santi Dottori della Chiesa vogliono, che altro fia *immagine*, altro *similitudine*, per il che dicono, che l'huomo fia ad imagine di DIO, per causa delle doti, e facoltà naturali, che riceuete per vivere, questa vita commune. *Alla somiglianza* di DIO, si dice essere per la grazia, e sua virtù sopra naturale. Pero *l'immagine*, che è il naturale, non si perde già mai, benché l'Anima fia nell'Inferno. Ma *la somiglianza* perdesi, perduta la grazia, la quale si perde, per qual'ui voglia peccato mortale⁸.

Po te ky autor gjurmohet dhe pranëvënia e emrave *shëkrime* e *sakrificia*, përdorur në një kontekst të Bogdani me vlerën e dy fjalëve sinonime:

Profetia është një të frymë o të ndritunë të Shpirtit Shëjt: ato kafshë qi janë për t'u goditunë, me një të temelitunë e të palëkundunë të dërejtë kallëzon. Ashtu tha Kasidori. Mbë shumë nëndyrë epetë ky hirt: ndo me vepër të nierëzet, posi kje kūr bani Noeu Profeta arkënë, sakrificiatë o shëkrimet' e Abramit, e të shkuemit' e Detit Kuq; ndo me të lemi të kujnaj, posi kje ata të Ezaut e Jakobit, qi shembëllente kafshë qi kishinë për t'ardhunë; ndo me të folë

⁸ P. Bogdani, *Cuneus prophetarum*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005, Shkall. I, Ligj. VI, f. 42.

t'engjijet, posikur folnë Abramit, Lotit e tjerëve; ndo me të pām, posikur e pā Ezaia et Exekia.

PROPHETIA est inspiratio, vel revelatio divi quæ eventus rerum vel per facta, vel per dicta immobili Veritate demonstrat, diffse il Calliodoro. In molti modi fī dā questa grazia ò per operatione delli huomini; come fù l' Arca di Noè, il sacrificio d'Abramo; il passaggio del Mar Rosso; ò per Natività; come fù quella di di Efau, e Giacob, la quale significava cose future; o con parlar delli Angeli; come quando parlarono ad Abramo, Loth, altri: o per visioni, come fu visto da Efaja, Ezechiele⁹.

Në veçanti përftesa të tilla aspak të lehta nëse kemi parasysh kontekstin në të cilat duhet të përfshihen dhe vetë tekstet që autori i veprës ka pasur burim referimi, dëshmojnë në të njëjtën kohë ndërmarrjen e tij në përpilimin tekstor të paragrafeve të caktuara, por dhe mundësitë e shfrytëzuara të shqipes në drejtim të zgjidhjes së përdorimit më të duhur a të përafërt në këto rasa.

Në pikëpamje shkrimtarie Pjetër Bogdani shquhet për pranëvendosjen e fjalëve që i dallon një afëri semantike e dukshme. Mund të citohen raste të tjera e që nuk përbëjnë pranëvënie të thjeshta fjalësh. Domethënia e një fakti të tillë është e nënvizueshme sidomos kur një tekst i tërë me referime të qarta ndaj burimesh nga fusha e teologjisë apo e ligjërimit biblik përforcohet nga të tilla përftesa:

Djali, anëniku i dorësë njerit, tue mos mujtunë me duruem qi nji kreatyrë, baltejet krijuem, të kish për ta mujtunë me të mira të vet, lëftoj me i bam **me hīm ndë faj e mpkat**.

Il Demonio nemico del genere humano, non potendo sopportare, che una creatura di fango creata, havessè à superarlo con le sue grandezze, cercò farla peccare¹⁰.

Gjurmimi tekstologjik në drejtim të këtyre veprave na shtyn ndër të tjera dhe në konstatime që kanë të bëjnë me shkallën e përdorimit të elementeve latine dhe atyre latino-romane; me elemente me

⁹ P. Bogdani, *Cuneus prophetarum*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005, Shkall. II, Ligj. I, f. 54.

¹⁰ P. Bogdani, *Cuneus prophetarum*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005, Shkall. I, Ligj. VII, f. 47.

originë të qartë greke, por që mund të kenë pasur një rrugë jo të zakonshme depërtimi në shqipe, arsyetuar me formimin e autorëve përkatës dhe shkallën e ngulitjes së trajtave të caktuara në regjistrin e liturgjisë; me elemente me prejardhje turke, denduria e të cilave ndryshon nga njëri autor në tjetrin.

Duke i parë elementet latine apo ato latino-romane në brendi të tekstit në të cilin përdoren, shihet qartë dhe fakti që konotacioni përkatës interpretohet pikërisht në këtë pikëpamje dhe pasurohet nëse vërehet që në paragrafe të tjera autori e ka ripërdorur duke plotësuar me ngjyrim të tjera.

Në rastin e foljes *fëj*, por dhe të përdorimeve të tjera te Pjetër Bogdani, këto interpretime kërkojnë pa dyshim dhe marrjen parasysh të tekstit referencial në gjuhën italiane, ndërkohë që Bogdani jo rrallë në krah të tekstit shqip ka fraza të tëra në gjuhën latine, ashtu siç i ka vjelë nga Vulgata latine. Këto të fundit e bëjnë më të mundshme analizën krahasuese dhe përballjen e natyrës tekstologjike e analitike, meqë citimi përkatës paraqitet më konciz dhe i prerë në përmbajtje.

Një linjë e tillë e gjurmuar te Bogdani ofron një mundësi të madhe për të vënë në dukje sa e rëndësishme paraqitet analiza e tekstit dhe konsiderimi i elementit tekstual për të evidentuar larminë e përdorimeve në vepër e më tej për të nënvizuar dhe faktin që të tilla përdorime vërtet qëndrojnë në një periudhë të ndërmjetme sa i takon pikëpamjes kronologjike, por përfaqësojnë realizime të arritura në drejtim të përfundimit të një regjistri specialistik në shqipen e saj kohe.

Çështja e vijimësisë së këtyre përdorimeve mandej duhet parë dhe në realizime të mëvona, që dhe në ditët tona shihet qartë se në njëfarë mënyre, falë dhe formimit të shqipëruesve të Biblës në gjuhën tonë dhe ngulmimit për t'i ruajtur përdorime të caktuara, i ritransmeton apo ripropozon ndërtime të caktuara në një dritë domethënëse dhe kuptimplote.

Rëndësinë që paraqet studimi tekstologjik i veprave të letërsisë së vjetër shqipe e përforcojnë natyrshëm botimet dhe rimarrjet në kohë që parapërgatitën realizime më të plota të këtyre veprave. Dhe pse në momente të caktuara mund të vërehen mbivlerësime

elementesh përmbajtësore që mund të mos jenë primare në këto vepra, çdo arritje në lidhje me to mbetet për t'u konsideruar në këndvështrimin e një historie letërsie të shkruar në gjuhën shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Shkodër, 1996.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1998.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Tiranë, 2000.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe V*, Shkodër, 2009.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe VI*, Shkodër, 2012.
- Bardhi, Sh. /(M. Kruja), *Mbi Fjalorin e Frangut të Bardhë*, në *Shêjzat*, I, nr. 2-3, 1957.
- Bogdani, P., *Cuneus prophetarum (botim kritik i përgatitur nga A. Omari)*, Tiranë, 2005.
- Borgia, N., *Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV(da un Manoscritto Greco della Biblioteca Ambrosiana)*, Grottaferrata, 1930.
- Budi, P., *Poezi (1618-1621), (botim kritik përgatitur nga R.Ismajli)*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Budi, P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Camaj, M., *Il «Messale» di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- Çabej, E., *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe(me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme)*, Shtypshkroja e Ministrisë s'Arsimit, Tiranë, 1936.
- Çabej, E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BUSHT*, n.2, 1959.
- Çabej, E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, *BUSHT*, nr.3, 1963.
- Çabej, E., *Studime gjuhësore VI (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij)*, Botime Rilindja, Prishtinë, 1977.

- Çabej, E., *Shqipja në kapërcyell – Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej, E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Demiraj, B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe “doktrina” e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj, B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Demiraj, B., *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P.Nikollë Kazazit*, Botime Françeskane, Shkodër, 2013.
- Demiraj, B., *Studi filologjici arbëreshë*, në *Albanistica* 5, Comet Editor Press, 2015.
- Demiraj, B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. I. Frang Mark Bardhi (1606-1643)*, në “Hylli i Dritës”, nr.1, 2016.
- Elsie, R., *Letërsia shqipe. Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2006.
- Fishta, F., *Nder gjurmimet e veprimit “De propaganda fide” në Balkan*, në “Hylli i Dritës”, nr.7-8, 1932.
- Fishta, F., *Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë*, në *BUSHT*, nr.3, Tiranë, 1962.
- Ismajli, R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, 2000.
- Lacaj, H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë shqipe*, në “Studime filologjike”, nr.4, 1966.
- Marquet, O., *Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*, Shkodër, 1997.
- Marlekaj, L., *Pietro Bogdani e l’Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- Matranga, L., *E mbsuame e krështerë,(a cura di M.Mandalà)*, Salvatore Sciascia editore, 2004.
- Matzinger, J., *L’ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale(“Messale”) di Gjon Buzuku*, në “Hylli i Dritës”, nr.4, 2010.
- Mulaku, R., *Gjuha e shkrimeve të vjetra shqipe(Shek.XV-XVIII)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012.
- Paci, E., *Kontributi i Justin Rrotës në fushë të letrave të shqipes*, në “Hylli i Dritës”, nr. 4, 2009.

- Paci, E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në “Hylli i Dritës”, nr. 2, 2011.
- Paci, E., *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në “Hylli i Dritës”, nr. 3, 2011.
- Paci, E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, (punim monografik), Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
- Paci, E., *Franciscus Blanchus: Dictionarium Latino-Epiroticum, Romæ 1635*, në *CERCETĂRI ISTORICE (Serie nouă)*, Editura Palatul Culturii, Iași, 2011.
- Paci, E., *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në “Hylli i Dritës”, nr. 1, 2012.
- Paci, E., *Le Missel de Gjon Buzuku, un ouvrage fondamental pour l'histoire des écrits anciens albanais*, në “Studia Albanica”, nr.1, 2012.
- Paci, E., *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese(1555)*, në “Studia Albanica”, nr.1, 2014.
- Paci, E., *Gjurmime rreth leksikut të liturgjisë në Mesharin e Gjon Buzukut*, në “Shëjzat”, nr.1-2, 2016.
- Paci, E., *Një traditë studimesh dhe botimesh mbi Fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit(1635)*, në “Hylli i Dritës”, nr. 1, 2016.
- Petrotta, G., *Popolo, lingua e letteratura albanese*(a cura di M.Mandalà), Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
- Ressuli, N., *I più antichi testi albanesi*, në “Shpirti Shqiptar”, nr.3, 1955.
- Ressuli, N., *Il “Messale di Giovanni Buzuku”, (riproduzione e trascrizione)*, Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958.
- Ressuli, N., *Shkrimtarët shqiptarë, I (nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë)*, Botime Pakti, Tiranë, 2007.
- Riza, S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- Riza, S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004.
- Riza, S., *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009.
- Roques, M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P.Geuthner, Paris, 1932.

- Roques, M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera, (perkthye nga frengishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga W.Kamsi)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- Rrota J., *Shkrimtari më i vjetri i italo-shqyparvet D.Lukë Matranga(1592); Copa të zgjedhuna e të komentuese për shkolla të mjesme*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1931.
- Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhësore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.
- Sciambra, M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua), saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Casa editrice Pàtron, Bologna, 1965.
- Schirò, G., *Storia della letteratura albanese*, Nuova Accademia, 1959.
- Sedaj, E., *Shqipja arbërore (në fillimet e filologjisë shqiptare)*, Prishtinë, 2002.
- Svane, G., *Formimi i gjuhës letrare të «Speculum Confessionis» e Budit*, në “Studime filologjike”, nr. 2, 1986.
- Zamputi, I., *Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit*, në “Buletin për Shkencat Shoqërore”, 1954, nr. 3.
- Zamputi, I., *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*, në “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës”, nr. 2, 1963.
- Zamputi, I., *Ricerche su Pjetër Bogdani*, në “Rassegna di studi albanesi”, Romë, 1964, nr. 1.
- Zamputi, I., *Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit*, në “Buletin i Universitetit shtetnor të Tiranës”, Seria shkencat shoqërore, 1958, nr. 2.
- Zamputi, I., *Mbi rrethanat historike të botimit të Mesharit të Gjon Buzikut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në “Studime filologjike”, nr. 3, 1986.
- Zamputi, I., *Les circonstances historiques de la parution du “Missel” de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në “Studia Albanica”, nr. 1, 1988.
- Zamputi, I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në “Hylli i Dritës”, nr. 1-2, 1995.

